



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
QERSHOR 2026

Nr. _____ Prot

Tiranë më ____ . ____ . 2026

Për dijeni: znj. Marjeta Përlala
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nga: Erilda Hoxha
KOORDINATORE E TË DREJTËS PËR INFORMIMIM

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigjia	Statusi	Pagesa
1.	12.05.2026	1. Kopje të vendimit të VNM të Kompleksit Multifunksional: Banimi, Shërbimesh, Hotelerie, Rekreacion, Marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6,	14.05.2026	Në vijim të kërkesës për informacion, ju informojmë si vijon: 1. Subjekti " Zvërnec South Adriatic Development" Sh.P.K , për projektin "Zvërnec Peninsula - Kompleks	Përfunduar	Nuk ka

		7, 8 kate, me vendndodhje në Zvërnec, subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" Sh.P.K. 2. Emrat e autorëve (ekspertë të licensuar) të VNM (Paraprake ose e Thelluar) 3. Kopje të mendimit të dhënë nga institucionet e konsultuara (AKZM; ARM, MM etj., referuar VNM në fjalë).		Multifunksional, Banimi, Shërbimesh, Hotelerie, Rekreacion, Marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Kate”me Vendndodhja: në Zvërnec, Bashkia Vlorë, ka aplikuar në sistemin e leje, për procedurën e VNM Paraprake, në zbatim të Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,të ndryshuar dhe VKM nr.686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar 2. Eksperti i licensuar është D*** B**** 3.Aplikimi është shpërndarë për mendim në institucionet përkatëse dhe është në proces në pritje të mendimeve të institucioneve. Në zbatim të VKM nr.686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, Agjencia Kombetare e Mjedisit nuk ka dalë me një vendim, aplikimi është në proces.		
2.	14.05.2026	1. A është pajisur projekti i kompanisë Zvërnec South Adriatic Development në zonën e Zvërnecit me VNM (Vlerësim të Ndikimit në Mjedis)? Nëse po, kërkojmë kopje të procedurës dhe vendimit. 2. Çfarë kategorie VNM-je është aplikuar, paraprake apo e thelluar? 3. Cilët janë nënkontraktorët e angazhuar nga Zvërnec South	19.05.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar, ju bëjmë me dije se: 1. Në zbatim të Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar dhe VKM 686, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) nuk ka dalë me një vendim, aplikimi është në proces, sapo të merret nje vendim, AKM i publikon në faqen zyrtare të çeb-it dhe janë publike.	Përfunduar	Nuk ka

		Adriatic Development për kryerjen e punimeve në terren? 4. A është kryer konsultim publik me komunitetin lokal, organizatat mjedisore dhe ekspertët e biodiversitetit? Nëse po, na vini në dispozicion listën përkatëse të emrave. 5. A ka AKM një raport të plotë mbi ndikimin e punimeve në dunat bregdetare, pyllin e pishës, lagunën e Nartës, korridorin e shpendëve migratorë? Nëse po, na e vini në dispozicion. 6. Pse nuk janë publikuar online dokumentet mjedisore dhe koordinatat e sakta të projektit?		Linku: https://akm.gov.al/cat_doc/vleresimi-i-ndikimit-ne-mjedis/ 2. Në zbatim të ligjit 10440 datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", gjatë procedurës së VNM-së, - Subjekti " Zvërnec South Adriatic Development" Sh.P.K , për projektin "Zvërnec Peninsula - Kompleks Multifunksional, Banimi, Shërbimesh, Hotelerie, Rekreacion, Marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 Kate"me Vendndodhja: në Zvërnec, Bashkia Vlorë, ka aplikuar në sistemin e leje, për procedurën e VNM Paraprake, në zbatim të Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,të ndryshuar dhe VKM 686, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar. 3. Nuk është kompetecë e sektorit të VNM-së. 4.Në zbatim te Vendim i KM nr. 247, datë 30.4.2014.Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" te ndryshuar Procesi i informimit dhe i përfshirjes së publikut gjatë procedurës paraprake të VNM-së përfshin Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektin, shoqëruar me Shpalljen dhe publikimin e vendimit të AKM-së në faqen e saj të internetit. 5. Nuk është kompetecë e sektorit të VNM-së. 6. Agjencia Kombetare e Mjedisit shqyrton aplikime të ardhura në sistemin e _leje, në e _Albania, vendimet e dhëna janë të publikuara në faqen zyrtare të web-it dhe janë publike.	
--	--	---	--	--	--

3.	13.05.2026	Kërkojmë informacionin e mëposhtëm për subjektin "E** OIL" SH.P.K Lutem të na vini në dispozicion një kopje të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme që ky subjekt ka depozituar pranë AKM-së si pjesë e Lejes së Mjedisit. Me cilin subjekt të licencuar për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme (Kodi i mbetjes: 13 07 03* - llumra nga depozitat) ka lidhur kontratë "E*** OIL" për vitet 2024-2026? Kërkoj kopje të Dokumenteve të Transferimit të Mbetjeve (DTSH), që vërtetojnë sasinë e llumrave të dorëzuar për asgjësim dhe destinacionin final të tyre për vitet 2024-2026."	20.05.2026	Nga verifikimi në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB subjekti i deklaruar nga ana juaj, subjekti "E*** OIL" ShPK nuk disponon leje mjedisi për ndikim në mjedisi me kod III.1. Operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”. Në linkun e mëposhtëm verifikoni Lejet e Mjedisit kategoria III.1 për ndikimin në mjedis si dhe licencat e nënkategorisë III.2.B: https://qkb.gov.al/leje-licensa-autorizime/ ose https://old.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/ Bazuar në Ligjin Nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit Nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”, Vendimit Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar si dhe Urdhërit të Ministrit me nr.135, datë 16.04.2015 për “Miratimin e mënyrës së administrimit të formatit të Regjistrit të transfertave individuale dhe të Regjistrit Kombëtar të Transfertave si dhe mënyrën e administrimit të tyre”,	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	--	------------	---	------------	--------

				Subjekti E**** OIL nuk është i pajisur me kod unik dhe si rrjedhojë nuk ka raportim pranë Sektorit të Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS në lidhje me transfertat individuale të mbetjeve.		
4.	18.05.2026	Vendosjen në dispozicion të Raprotit Paraprak të VNM-së për projektin Zvërnec Peninsula-Kompleks Multifunksional banimi dhe shërbimesh, hotelerie, rekreacioni dhe marina me godina 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8 kate me vendndodhje Zvërnec, me subjekt zhvillues shoqërinë Zvërnec South Adriatic Developoment shpk	29.05.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatëse. Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë.	Përfunduar	Nuk ka
5.	20.05.2026	Lidhur me kërkesën tonë për informacion mbi menaxhimin e mbetjeve nga subjekti “E**** OIL” SH.P.K, si dhe bazuar në interesin publik për transparencë mbi administrimin e mbetjeve me kod 13 07 03* (llumra nga depozitat), kërkojmë informacion shtesë si më poshtë: 1. A është kontrolluar subjekti “E**** OIL” SH.P.K nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit apo nga	20.05.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar, ashtu si jeni vënë në dijeni edhe në përgjigjen e datës 20.05.2026, subjekti në fjalë nuk disponon leje mjedisi apo kod unik. AKM ushtron veprimtarinë e saj inspektuese në përputhje me Ligjin Nr.99/2024 “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të përditësuar, si dhe VKM Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.	Përfunduar	Nuk ka

		strukturat inspektuese përgjegjëse për çështjet mjedisore? 2. A është konstatuar nga AKM mungesa e Lejes Mjedisore apo mungesa e regjistrimit me kod unik për raportimin e transfertave të mbetjeve për këtë subjekt? 3. A janë marrë masa administrative ndaj subjektit “E*** OIL” SH.P.K në lidhje me: · menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme; · mungesën e raportimit; · mungesën e dokumentacionit për transferimin e mbetjeve;		Referuar kuadrit ligjor në fuqi, AKM ushtron funksione inspektuese vetëm ndaj operatorëve ekonomikë të pajisur me Leje Mjedisore të tipit A dhe B. Në zbatim të diskrecionit administrativ dhe kompetencës lëndore si dhe Urdhërit të Inspektoriatit Qendror Nr. 29, datë 30.08.2023, pikat 2 dhe 3, për “Zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për IKMT dhe AKM”, percakton se 2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në Lejet Mjedisore. 3. Trupa inspektuese e IKMT, kur konstaton se operatori me Leje Mjedisore ka thyer kushtet e lejes mjedisore, të njoftojë pa vonesë Inspektoratin Qendror edhe për kompetencë Inspektoratin e AKM-së, reciprokisht inspektorët e AKM-së, nëse marrin indicie, apo konstatojnë në flagrancë aktivitet mjedisor pa leje mjedisore, të njoftojnë Inspektoratin Qendror edhe Inspektoratin e IKMT-së, për kompetencë.		
6.	21.05.2026	Ju kërkojmë të na vini në dispozicion informacion lidhur me HEC-et që operojnë në shebenik. Hecet si më poshtë; -hec Gizavesh-Dardania Green Energy -hec stebilece- Pure Energji Stevleva Hec Qarrishte	03.06.2026	Në përgjigje të kërkesës, ju informojmë se nga sektorët e ujërave të AKM Qendër dhe AKM Rajonale Berat–Elbasan–Korçë janë kryer inspektime në HEC-et që operojnë në zonën e Shebenikut, si më poshtë: • HEC Gizavesh – subjekti “Dardania Green Energy”; • HEC Steblevë – subjekti “Pure Energy”; • HEC Qarrishtë – subjekti “IDI 2005”;	Përfunduar	Nuk ka

		Hec Rrapun1- C& S Constrution Hec Rrapun 2- C&S construction 1-Kopje të lejes mjedisore për operim të Hec-it të lëshuar nga AKM 2-Kopje të VNM për secilin Hec 3-Sa është rrjedha natyrore e percaktuar ne lekën e operimit 4-Kur është hera e fundit që AKM ka bërë inspektim për zbatimin e lejes dhe matje për rrjedhën natyrore 5-Sa ka qenë rrjedha natyrore e regjistruar në inspektimet apo vetëdeklarimet e dy viteve të fundit 6-Një kopje të procesverbaleve të inspektimeve a po vetëdeklarimeve		• HEC Rrapun 1 & 2 – subjekti “C&S Construction”. Bashkëlidhur gjeni Vendimet Përfundimtare të Inspektimit për subjektet e sipërpërmendura. Lidhur me rrjedhën natyrore (ekologjike), sqarojmë se monitorimi dhe verifikimi i respektimit të saj është pjesë e objektit të inspektimit të inspektorëve të ujërave. Në rastet kur konstatohet cenimi i rrjedhës ekologjike, ndaj subjektit merren masat administrative përkatëse, si dhe konstatimet përkatëse pasqyrohen në Vendimin Përfundimtar të Inspektimit. Sa i përket kërkesës për kopje të VNM bëjmë me dije se nga verifikimi në sistemin e-leje nuk rezultojnë të jenë pajisur me vendim për VNM.		
7.	22.05.2026	Në vijim të interesit të treguar mbi aktivitetin e shoqërisë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k. në Peizazhin e Mbrojtur Pishë-Poro-Nartë, vijoj të kërkoj si më poshtë, 1. Njoftimin e publikuar nga ana e Agjencisë (pasi nuk po e gjej në faqen tuaj online) mbi nisjen e	02.06.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatëse.	Përfunduar	Nuk ka

		<i>procedurës për realizimin e VNM nga shoqëria në fjalë.</i>		Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë.		
8.	25.05.2026	1-A ka Ministria e Mjedisit informacion zyrtar mbi ndërhyrjet që po kryhen aktualisht në zonën e mbrojtur Pishë Poro-Nartë? Nëse po, ju lutem specifikoni natyrën e ndërhyrjeve të eventuara? 2-Cili është subjekti/kompania që po kryen punimet apo ndërhyrjet në territorin e zonës së mbrojtur? Ju lutem na vendosni në dispozicion emrin e plotë të subjektit, NIPTIN dhe cdo informacion mbi kontraktimin apo autorizimin e tij? 3-A është pajisur ky subjekt me leje mjedisi, deklaratë mjedisore apo ndonjë autorizim tjetër për kryerjen e punimeve në këtë zonë? Nëse po, ju lutem dërgoni kopje të dokumentacionit përkatës? 4-A është zhvilluar procedurë e VNM/ VNM Paraprake për këto ndërhyrje? Nëse po, cili ka qenë vendimi përfundimtar i Ministrisë apo i AKM?	29.06.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësiive përkatëse. Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë.	Përfunduar	Nuk ka

		5-A ka kryer Ministria e Mjedisit, AKZM apo IKMT inspektime në terren lidhur me këtë rast? Nëse po , cilat kanë qenë gjetjet? 6-A janë konstatuar shkelje të ligjit mjedisor apo të legjislacionit për zonat e mbrojtura nga subjekti që po kryen ndërhyrjet? Nëse po, cfarë masash administrative apo ligjore janë marrë? 7-A ka kryer ministria pezullimin e punimeve apo ndalimin e aktivitetit deri në verifikimin e plotë të situatës në terren? 8-Duke qenë se zona e Pishë Poro-Nartë konsiderohet abitat me rëndësi të vecantë ekologjike, cfarë masash konkrete po merr ministrai për garantimin e mbrojtjes së integritetit ekologjik të saj?				
9.	28.05.2026	Në lidhje me aplikimin e subjektit Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali i Skavicës” me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Desha të di nëse: 1-subjekti ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së	28.05.2026	Referuar kërkesës për informacion në lidhje me subjektin “Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare” sh.a për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin “Hidrocentrali Skavicës” me vendndodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së të thelluar.	Përfunduar	Nuk ka

		të thelluar? 2-Nëse po, më nisni dokumentet përkatëse.				
10.	01.06.2026	1. Dokumentacioni për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). A është paraqitur pranë AKM-së ndonjë “raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin “Zvërnec South Adriatic Development”? Nëse po, kërkoj kopje të plotë të raportit dhe të gjithë anekseve përkatëse. 2. Vendimarrja e AKM-së Kopje e çdo “vendimi, mendimi teknik, miratimi ose refuzimi” të dhënë nga AKM në lidhje me këtë projekt. Nëse procedura është në proces, kërkoj informacion mbi “fazën aktuale të shqyrtimit”. 3. Leje mjedisore. A është pajisur subjekti “Zvërnec South Adriatic Development” me “Leje Mjedisore (Tip A ose B)”? Nëse po, kërkoj kopje të plotë të lejes dhe kushteve të vendosura. 4. Konsultimi public Kërkoj informacion nëse është zhvilluar “konsultim publik mjedisor” për këtë projekt, përfshirë: datat e zhvillimit pjesëmarrësit procesverbalet dhe dokumentacionin përkatës 5. Korrespondenca institucionale	08.06.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatëse. Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë.	Përfunduar	Nuk ka

		Kopje e çdo “correspondence zyrtare ndërmjet AKM-së dhe: Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT) Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) Bashkisë së Vlorës subjektit zhvillues 6. Statusi mjedisor i zonës Informacion mbi mënyrën se si është vlerësuar “ndikimi i projektit në zonën e mbrojtur Vjosë–Nartë”, përfshirë çdo raport teknik të brendshëm ose studim të përdorur nga AKM.				
11.	01.06.2026	Kërkojmë të vihemi në dijeni nëse për vendburimin e naftës Kocul-Gorisht është bërë raport vlerësimi, studim në lidhje me ndotjen e mjedisit dhe shëndetit të punonjësve dhe banorëve të zonës si dhe pasojat që ka sjellë ose vazhdon të sjellë kjo ndotje? Gjithashtu nëse është konstatuar ndotje, parregullësi neglizhencë nga shoqëria A**** sh.a, veprimet konkrete që janë marrë gjoba ose masa të tjera shtrënguese.	09.06.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju bëjme me dije se : Agjencia Kombëtare e Mjedisit së bashku me Agjencinë Rajonale të Mjedisit Fier,Vlorë, Gjirokastër kanë kryer inspektime të rregullta dhe të vazhdueshme në subjektin Albpetrol sh.a si dhe përgjatë të gjithë rrjedhës së lumit Vjosa. Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastër për cdo inspektim ku janë konstatuar shkelje, ka vendosur masa administrative dhe ka lënë detyra për rehabilitimin e zonave të prekuara për të dyja lejet mjedisore Konkreisht janë marrë masa administrative gjobë dhe masa të tjera plotësuese . U vendosën në dispozicion procesverbalet dhe vendimet e inspektimeve.	Përfunduar	Nuk ka
12.	01.06.2026	Dëshiroj të paraqes ankesë në lidhje me ndotjen që shkaktohet	09.06.2026	Lidhur me ankesën ndaj subjektit “Tegola Edilcentro “ mbi erën e rëndë dhe marrjen e masave për ndalimin e ndotjes dhe	Përfunduar	Nuk ka

		nga fabrika e tullave që ndodhet në zonën Laprakë. Kërkojmë nga institucinet përgjegjëse: Kryerjen e një kontrolli mjedisor, verifikimin e filtrave dhe kushteve teknike të favrikës. Marrjen e masave për ndalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e shëndetit të banorëve.		mbrojtjen e shëndetit të banorëve , ju bëjme me dijeni si më poshtë vijon ; Referuar ankesës së mësipërme për subjektin “Tegola Edilcentro “ në rrugën “ Iliria “ , Nd 18/1, Laprakë , Tiranë u gjenerua autorizimi i inspektimit me Nr AKM-TR-2026-000-258-1, datë 04.06.2026 ku procedimi administrativ i inspektimit filloi pa njoftim të autorizimit të inspektimit sipas shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 40 të ligjit 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Nga inspektimi i kryer në subjektin “Tegola Edilcentro” i pajisur me leje mjedisore e tipit A, rezultoi se: 1 –Subjekti ka kryer raportet e vetmonitorimit 3 mujore dhe raportin vjetor me studjo të licensuar dhe të akredituar për elementët e matjeve në ajër, ujë, toke dhe zhurma dhe I ka dorëzuar pranë AKM-së 2-Ka kryer pagesën vjetore të lejes së mjedisit 3- Disponon kontratë për mbetjet që gjeneron gjatë procesit të punës me operatorë të licensuar 4. Subjekti nuk ka bërë izolimin e makinerisë së shkriftimit të argjilës ku futet lënda e parë që e kthen në gjendje të imet që të bëjë të mundur minimizimin e shkarkime të pluhurave në ajër 5 – Subjekti nuk kryen spërkatjen me ujë që të përmirësojë ambientin dhe të shmangë pluhurat Si rezultat i fakteve dhe konstatimeve në Procesverbalin e Inspektimit me Nr. AKM-TR-2026-000258 - 1, datë 05.06.2026, dhe në zbatim të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", për shkeljet e kërkesave ligjore në inspektimin e parë të trupës së inspektimit që përbëjnë kundërvajtje		
--	--	--	--	--	--	--

				administrative, ndaj subjektit u parashikua masë administrative “Paralajmërim” Subjektit ju la detyrë brenda 8 ditëve nga njofitimi i këtij procesverbali të marri masa të menjëhershme si më poshtë vijon: 1-Të bëjë matjet për shkarkimet në ajër për 7 ditë në 24/7 nga një ekspert mjedisi ku të ketë laborator të akredituar dhe të liçensuar me liçensat përkatëse dhe ti dorëzoje rrezultatet përfundimtare pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër. 2- Të bëjë të mundur izolimin e makinerisë së shkriftimit të argjiles ku futet lenda e parë që e kthen në gjendje të imët që të mundësojë minimizimin e shkarkime të pluhurave në ajër 3 – Të kryejë spërkatjen me ujë të ambientit nga magazinimi deri te makineria e shkriftimit në mënyrë që të shmangen pluhurat		
13.	02.06.2026	Njësia Administrative Vaqarr, Fshati Buliticë, qytetari ankohet për ndotje mjedisore nga aroma të rënda të cilat shkaktohen nga djegia e produkteve dhe dhjamrave shtazorë nga ferma “B*** Zoo Farm 2014”. U verifikua se subjekti është i pajisur me leje mjedisore. Në momentin e kontrollit nuk u konstatuan aroma të pakëndshme. Ju bëjmë me dije se Policia Bashkiake nuk ka aparatura dhe personel të specializuar për matjen e tyre. Kërkohet të njoftohet AKM.	12.06.2026	Nga verifikimi në regjistrin kombëtar të lejeve dhe licencave pranë QKB-së rezulton se subjekti është i pajisur me leje mjedisi kategoria III.1.B me veprimtari: “thertore, asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përvec shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce, trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përvec qumështit), magazinimi frigoriferik i produkteve ushqimore të ambalazuara, rritje intensive e derrave në një instalim’ me vendndodhje “Tiranë, Vaqarr, Zona Damjan, Godinë 2 katëshe, në ZK 1441, Nr.Pasurie 15/9.	Përfunduar	Nuk ka

				Referuar rastit në fjalë, Drejtorai e Menaxhimit të të Dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit (Laboratori) nuk kryen matje të odoreve. Për sa më sipër, ankesa në fjalë është jashtë fushës analitike dhe veprimtarisë së AKM-së, referuar VKM-së Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”.		
14.	01.06.2026	Spektori veterinar i Bashkisë ushtron funksionet në bazë të ligjit Nr.10465/2011 “Për shërbimin veterinar në RSH”, neni 54, pika ç) dhe zbaton VKM-në Nr.475/2021 “Për bashkëpunimin e njësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar”, referuar këtij ligji mbajtja e kafshëve të shoqërimit lejohet, për sa kohë respektohen kushtet e mirëqënies së tyre dhe nuk përbën rrezik për shëndetin public. Për sa i përket numrit të kafshëve, ligji veterinar nuk ka një kufizim numerik të përcaktuar. Për ndotjen akustike (sjellje fiziologjike e kesaj kategorie kafshe) është çështje që trajtohet nga stukturat përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike.	03.06.2026	Në përgjigje të emailit tuaj, lidhur me ankesën e paraqitur nga z. Shkëlqim Huqi për shqetësimin e pretenduar nga zhurmat e shkaktuara prej qenve të mbajtur në një banesë private, ju bëjmë me dije se, referuar VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, si dhe Ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ushtron funksione inspektimi vetëm për kontrollin e zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore të tipit A dhe B dhe të kërkesave të legjislacionit mjedisor nga subjektet që ushtrojnë veprimtari të pajisura me këto leje. Gjithashtu, referuar nenit 8 të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis”, të ndryshuar, bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga burimet e zhurmës brenda juridiksionit të saj. Për sa më sipër, vlerësojmë se trajtimi i kësaj çështjeje nuk bën pjesë në fushën e kompetencës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, por mund të trajtohet nga stukturat e njësive të vetëqeverisjes vendore, shërbimi veterinar përkatës, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV), si dhe stukturat përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe qetësisë	Përfunduar	Nuk ka

				publike, sipas kompetencave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.		
15.	03.06.2026	1. Organizatat mjedisore (PPNEA dhe AOS) kanë denoncuar se subjekti zhvillues ka future makineritë e rënda në terren më datë 30.04.2026, përpara datës së raportit paraprak të VNM-së (01.05.2026). Mbi çfarë baze ligjore dhe mjedisore ka lejuar AKM-ja fillimin e punimeve dhe ndërhyrjen e habitatit në një zonë "Emerald" pa u pajisur subjekti me një VNM të thelluar, duke pasur parasysh specifikat kritike të ekosistemit? 2. Raportet paraprake të siguruara nga shoqëria civile dëshmojnë se pjesë e dokumentacionit është edhe ndërtimi i një marine (port jahtesh) në këtë zonë ligatine. A ka kryer AKM-ja një vlerësim strategjik mjedisor për impaktin që një strukturë e tillë detare ka mbi rrugët e shtegtimit të shpendëve ujorë dhe nëse po, ku mund të konsultohet ky dokument? 3. Cilat janë masat që keni ndërmarrë ndaj subjekteve që kanë hyrë në terren përpara daljes së VNM-së paraprake?	10.06.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësiive përkatëse. Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrushmërinë mjedisore afatgjatë.	Përfunduar	Nuk ka

16.	04.06.2026	Kam bërë kërkesë për depot e naftës të puseve të cilat janë përball shtëpisë time të cilat janë derdhur jashtë dhe kanë mbushur një gropë 3m ³ me naft e cila kundërmon dhe nuk të lejon të marrësh frymë. Këtë ankesë e kam bërë edhe tek Qendra e Përpunimit të Naftës Kucovë për 3 vite rresh por asnjë masë nuk është marrë. Bashkëlidhur po ju dërgoj fotot. Nafta vazhdon e rrjedh në Grupin 94 Bashkia Kucovë, fshati Havaleas.	12.06.2026	Në vijim të trajtimit të "Ankesës" së percjell pranë ARM Berat/Elbasan/Korcë , lidhur me shqetësimet e percjella banor i fshatit Havales, Njësia Administrative Kozare, Bashkia Kuçovë, si dhe në vijim të mbylljes së procedurës inspektuese ju bëjmë me dije se: Në datë 23.06.2026, trupa inspektuese e ngritur për trajtimin e " Ankesës" ka vendosur Masë Administrative ndaj subjektit A**** sh.a. Bashkëngjitur Vendimi përfundimtar Inspektimit.	Përfunduar	Nuk ka
17.	05.06.2026	Në kuadër të transparencës publike, ne kemi një pyetje përsa i përket projektit që po zhvillohet në Vlorë nga kompania "Zvërnec South Adriatic Development" shpk: 1. A ka miratuar VNM Agjencia Kombëtare e Mjedisit për punimet në Zvërnec për zonën peisazhi i mbrojtur Pishë Poro Nartë?	12.06.2026	Agjencia Kombëtare e Mjedisit në zbatim të VKM-së Nr.568, datë 17.07.2019 " <i>Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit</i> ", të Ligjit Nr.10431 datë 09.06.2011 " <i>Për mbrojtjen e mjedisit</i> ", Ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 " <i>Për vlerësimin e ndikimit në mjedis</i> " të ndryshuar, gjatë procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis merren mendimet e institucioneve të tjera sipas funksioneve dhe përgjegjësi përkatese. Për sa më sipër Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kërkuar të ndiqet procedura e Vlerësimit të Thelluar e Ndikimit në Mjedis, për të shqyrtuar efektet e mundshme mjedisore mbi habitatet, ekosistemin bregdetar dhe lagunor, si dhe qëndrushmërinë mjedisore afatgjatë.	Përfunduar	Nuk ka
18.	05.06.2026	Jam banuese në zonën e Astirit, rrethqarkullimi i madh, pallati në buzë të rrugës. Në pjesën e brendshme të këtij pallati ndodhet një local. Ky bar local hap dyert dhe	24.06.2026	Në përgjigje të ankesës lidhur me shqetësimin e shkaktuar nga zhurmat e gjeneruara nga aktiviteti i subjektit "SPIRIT", në zonën e Astirit, ju bëjmë me dije sa vijon:	Përfunduar	Nuk ka

		ne pjesën e cadrave ka instaluar dhe një ekran të madh, si dhe ka vënë bokse jashtë. Ky ekran shërben për të parë ndeshjet e futbollit jashtë, me zë të lartë. Ju lutem ndërhyni sepse shqetësohemi brenda shtëpive tona.		Pas shqyrtimit të problematikës së paraqitur dhe kuadrit ligjor në fuqi, rezulton se kompetenca për trajtimin e rasteve të zhurmës së gjeneruar nga aktivitete që ushtrohen brenda territorit administrativ të bashkisë u përket strukturave të pushtetit vendor dhe organeve përgjegjëse për garantimin e qetësisë publike. Në zbatim të Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar, përgjegjëse për marrjen e masave ndaj burimeve të zhurmës janë bashkitë, me përjashtim të rasteve që lidhen me subjekte të pajisura me leje mjedisore të tipit A dhe B. Nga verifikimet e kryera nuk rezulton që aktiviteti i referuar të jetë subjekt i pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B. Për rrjedhojë, trajtimi i problematikës së raportuar nuk bën pjesë në kompetencat e institucionit tonë. Për sa më sipër, ankesa juaj duhet t’u referohet Bashkisë Tiranë, Policisë Bashkiake dhe strukturave të Policisë së Shtetit, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, janë organet kompetente për kryerjen e verifikimeve në terren, marrjen e masave administrative dhe garantimin e qetësisë publike.		
19.	06.05.2026	Po ju drejtohem lidhur me një objekt që po ndërtohet nga shtetasi I**** K****, vetëm 10 metra larg shtëpisë sime. Ndonëse para një viti inspektimet konstatun se objekti ishte thjesht një “magazinë” siuate sot ka ndryshuar rrënjësisht dhe kërkon ndërhyrje të menjëherëshme. Infrastruktura industriale	05.06.2026	Bazuar në ligjin Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjin Nr.99/2024 “Për inspektimin në RSH”. Në mbështetje të VKM-së Nr.867/2014 “Për procedurën e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” i ndryshuar dhe VKM-së Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të AKM-së” i ndryshuar, në verifikim të ankesës, ju bëjmë me dije se Drejtoria Rajonale e Agjencisë Rajonale të Mjedisit në përmbushje të	Përfunduar	Nuk ka

				detyrave të veta kontrollon dhe monitoron ndikimet negative në mjedis gjatë fazës ndërtimore të projektit. Në këto rrethana është kryer inspektimi mbi zbatimin e kushteve të vendimit për VNM Paraprake në subjektin “Vëllëzërit Derviashaj” për zhvillimin e projektit “Magazinë për grumbullimin dhe përbunimin e produkteve bujqësore”, me vendndodhje :Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Dushk, Fshati Gramsh, u konstatua se : objekti kishte përfunduar ndërtim por nuk kryhej aktivitet ekonomik në këtë godinë. Objekti ishte i rrethuar dhe i mbyllur. Personat zhvillues të projektit nuk ishin të pranishëm. Nga kontakti me firmën ndërtuese që kanë qenë të kontraktuar për zhvillimin e këtij projekti na është vendosur në dispozicion dokumentacioni për zbatimin e kushteve të VNM Paraprake, ku rezultoi se operatori i kontraktuar për ndërtimin e objektit ka zbatuar kushtet e Vendimit për VNM-në paraprake në cdo fazë të zhvillimit të projektit.		
20.	17.06.2026	Në lagjen ku jetojmë, zhvillon aktivitetin e grumbullimit të kromit dhe transportit. Kamjonat e subjektit kalojnë me shpejtësi dhe me shumë zhurm. Lutemi për zgjidhje.	19.06.2026	Në përgjigje të ankesës, ju bëjmë me dije se referuar Shtojcës 1 të ligjit nr. 52/2020, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, të ndryshuar”, depozitimi i kromit nuk përfshihet në kategoritë e veprimtarive që i nënshtrohen pajisjes me Leje Mjedisore të Tipit A dhe B. Gjithashtu, në zbatim të VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëpërmjet strukturave të saj inspektuese, ushtron funksione kontrolli dhe inspektimi vetëm ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari të pajisura me Leje Mjedisore të Tipit A dhe B. Për sa më sipër, aktiviteti i referuar në ankesën tuaj nuk përbën objekt kompetence për inspektim nga Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.	Përfunduar	Nuk ka

				Sa i përket shqetësimeve të ngritura për zhurmën, pluhurin, qarkullimin e mjeteve të tonazhit të rëndë, sigurinë rrugore dhe respektimin e rregullave të qarkullimit, për trajtimin e tyre mund t'u drejtoheni Bashkisë përkatëse, Policisë Bashkiake, Policisë së Shtetit, si dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), sipas fushave përkatëse të kompetencës.		
21.	24.06.2026	1.Kopje e plotë e raporteve të vetëmonitorimit për periudhën 2020-2025 të depozituara pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga kompania KURUM INTERNATIONAL me nipt K02727230T. 2. Kopje e plotë e raporteve të vetëmonitorimit për periudhën 2020-2025 të depozituara pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga kompania FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY me nipt K71827801E. 3. Kopje e plotë e raporteve të vetëmonitorimit për periudhën 2020-2025 të depozituara pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga kompania ALBCHROME (Ish ALBANIAN CHROME (Ish DARFO ALBANIA) me nipt K11613001M. 4. Kopje e plotë e çdo mase administrative dhe procesverbali inspektimi të mbajtur për periudhën 2020-2025 nga Agjencia	06.07.2026	U vendosën në dispozicion materialet në Cd	Përfunduar	Nuk ka

		Kombëtare e Mjedisit ndaj kompanisë KURUM INTERNATIONAL me nipt K02727230T. 5. Kopje e plotë e çdo mase administrative dhe procesverbali inspektimi të mbajtur për periudhën 2020-2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndaj kompanisë FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY me nipt K71827801E. 6. Kopje e plotë e çdo mase administrative dhe procesverbali inspektimi të mbajtur për periudhën 2020-2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndaj kompanisë ALBCHROME (Ish ALBANIAN CHROME (Ish DARFO ALBANIA) me nipt K11613001M.				
22.	19.06.2026	-Cila është gjendja aktuale e cilësisë së ajrit në Shqipëri? -Cilët ndotës monitorohen rregullisht nga AKM? - Sa stacione monitorimi të cilësisë së ajrit funksionojnë aktualisht në Shqipëri? Ju lutem na vini në dispozicion vendndodhjen e tyre		AKM në zbatim të VKM-së Nr.568/2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, si dhe në zbatim të VKM-së Nr.1189/2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit”, mbështetur në ligjin Nr.10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin Nr.10266/2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8897/2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga	Përfunduar	Nuk ka

				ndotja” realizon monitorimin e cilësisë së ajrit urban me stacione automatike në qytetet si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë për treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban PM10, PM 2.5, NO ₂ , SO ₂ , O ₃ , CO dhe BTEX.		
23.	24.06.2026	Jam nje qytetar italian qe banoj ngjitur me pularin Kur e mora shtepin aty ishte thjesht nje toke boshe Me pas u ndertua nje pulari qe nuk ka zbatuar largesin nga qendrat e banuara dhe ndot ajrin Nuk hapim dot dyert dhe dritaret Kam bere denocim ne polici bashki dhe aku Pres qe te vini dhe ta verifikoni	24.06.2026	Pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ka ardhur kërkesa e z.Fabrizio Tucillo në lidhje me ndërtimin e një pularie, e cila sipas adresës bashkëlidhur rezulton Rruga Momelgjoc i Ri, Kavajë. Nga të dhënat e komunikimit, nuk arrihet të identifikohet subjekt i pajisur me leje mjedisi të tipit A ose B. AKM ushtron veprimtarinë e saj inspektuese në përputhje me Ligjin Nr.99/2024 “Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të përditësuar, si dhe VKM Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, AKM ushtron funksione inspektuese vetëm ndaj operatorëve ekonomikë të pajisur me Leje Mjedisore të tipit A dhe B. Në zbatim të diskrecionit administrativ dhe kompetencës lëndore si dhe Urdhërit të Inspektoriatit Qendror Nr. 29, datë 30.08.2023, pikat 2 dhe 3, për “Zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushën e veprimtarisë inspektuese të mjedisit për IKMT dhe AKM”, percakton se 2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, të ushtrojë veprimtarinë në fushën e përgjegjësisë shtetërore, vetëm për rastet e inspektimit të përputhshmërisë të aktivitetit të operatorëve me kushtet/kriteret e përcaktuara në Lejet Mjedisore. Për sa më sipër gjeni për trajtim dhe kompetencë rastin në fjalë.	Përfunduar	Nuk ka

24.	25.06.2026	1. Ju lutem konfirmoni sa Vendime të Ndikimit në Mjedis janë miratuar nga Janar 2020 – Qershor 2026. 1.1. Për secilin VNM të miratur, ju lutem konfirmoni në formë tabelore subjektin, projektin, zonën juridiksionale (Bashki). 2. Ju lutem konfirmoni sa Vendime të Ndikimit në Mjedis janë refuzuar nga Janar 2020 – Qershor 2026. 2.1. Për secilin VNM të refuzuar, ju lutem konfirmoni në formë tabelore subjektin, projektin, zonën juridiksionale (Bashki), dhe arsyen e refuzimit	29.06.2026	Në vijim të informacionit të kërkuar, administruar në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit me Nr.9472 prot datë 25.06.2026, ju bëjmë me dije se të gjitha vendimet e dhëna nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit janë publike, dhe publikohen në faqen zyrtare të saj konkretisht në link: https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-vnm-te-per-periudhen-janar-2014-qershor-2024/. Lutemi referohuni link sipërcituar.	Përfunduar	Nuk ka
-----	------------	---	------------	--	------------	--------